



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot 279

Tiranë, 29.2.2024

Vendim nr. 25 datë 29.2.2024
Për riorganizimin e komisioneve të përhershme

Referuar neneve 39 dhe 40 të Statutit të Akademisë së Shkencave;

Në vijim të nismave të ndërmarra në zbatim të VKM nr. 821 *Për ngritjen dhe organizimin e njësisë të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë;*

Referuar ndryshimeve në Statut të miratuara nga Asambleja në mbledhjen e datës 23 shkurt 2024, që përfshijnë emërtimin e disa prej komisioneve të përhershme pas ndarjes së tyre, si rezultat i riorganizimit në përputhje me njësitë e reja të kërkim-studimit në albanologji;

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 26.02.2024,

Vendosi:

1. Të ngrihen komisionet e reja të përhershme me emërtimet në vijim: komisioni i përhershëm i arkeologjisë, komisioni i përhershëm i historisë, komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe letërsisë, komisioni i përhershëm i antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore dhe komisioni i përhershëm i arteve.

2. Anëtarët e Asamblesë të bëjnë pjesë në komisionet përkatëse të fushës së tyre si në vijim: akad. Muzafer Korkuti, akad. Apollon Baçe, akad. Adem Bunguri dhe akad. Asoc. Gëzim Hoxha në komisionin e arkeologjisë; akad. Pëllumb Xhufi, akad. Marenglen Verli dhe akad. Beqir Meta në komisionin e historisë; akad. emeritus Jani Thomai, akad. emeritus Ismail Kadare, akad. emeritus Xhevahir Spahiu, akad. emeritus Ethem Likaj, akad. emeritus Gjovalin Shkurta; akad. emeritus Floresha Dado, akad. Valter Memisha dhe akad. asoc. Kristina Jorgaçi në komisionin e gjuhësisë dhe letërsisë; akad. emeritus Mark Tirta, akad. Albert Doja, akad. Shaban Sinani dhe akad. emeritus Emin Riza në komisionin e antropologjisë dhe trashëgimisë

kulturore; akad. Vasil S. Tole, akad. asoc. Stefan Çapaliku dhe akad. Fatos Kongoli në komisionin e arteve;

3. Kryetar i komisionit të arkeologjisë të caktohet prof. Neritan Ceka; i komisionit të historisë prof. Paskal Milo; i komisionit të gjuhësisë dhe letërsisë prof. Anila Omari; i komisionit të antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore akad. Albert Doja dhe i komisionit të studimit të arteve akad. Vasil Tole;

4. Deri më 20 mars drejtuesit e komisioneve, në bashkëpunim me drejtorët e institutive, të paraqesin listën e plotë të anëtarëve të tyre, duke përtëritur përbërjen sipas meritës e kontributit e duke ruajtur raportet statutoare; si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm (5-6 për komision, kërkues shkencor shqiptarë me veprimtari jashtë vendit);

5. Deri në fund të muajit mars të miratohet përbërja e anëtarësisë së këtyre komisioneve dhe të konstituohet fillimi i veprimtarisë së tyre;

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: sekretari shkencor e kryetarët e komisioneve të përhershme.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

